

50

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETARE I UJIT**  
**KESHILLI BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

---

**V E N D I M**

-----

**Numer 1 Date 02.11.2007**

-----

**“Per**  
**Mbeshtetje te kerkeses nr. 8012 prot. dt. 26.10.2007 te Ministrit**  
**Te Ministrise Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes”**

Bazuar ne kerkesen e bere me shkrese nr. 8012 prot. dt. 26.10.2007 per “Per miratim ne parim per perdorim te rezerves ujore lumi Drini i Zi bere nga Ministri i METE-s, drejtuar Kryetarit te K.B.U.-se Drin-Bune z. Maxhid CUNGU, si dhe prioriteteve qe ka qeveria per rritjen e kapaciteteve per prodhim te energjise elektrike, K.B.U. Drin-Bune

**V E N D O S I :**

Te mbeshtese kerkesen e Ministrit te METE-s z. Genc RRULI per perdorim te rezerves ujore te territorit te lumit Drini i Zi per prodhim te energjise elektrike, me kusht qe prdorimi i kesaj rezerve te mos krijoje efekte negative per komunitetin e kesaj zone.

**PER K.B.U. DRIN – BUNE**

**K R Y E T A R I**

*Maxhid CUNGU*  
**Maxhid CUNGU**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QARKU SHKODËR  
PREFEKTI**

*Prefekti i Qarkut Shkodër, Adresa: Rruga "13 Dhjetori", tel/fax 003552242705, e-mail prefeshk@abcom-al.com*

Nr. 8012 Prot

Shkodër, me 07.11.2007

**Lënda:** Përgjigje kërkesës mbi miratimin në parim të përdorimit të rezervës ujore të lumit Drin i Zi

**Drejtuar:**

**Z. Genc RULI  
MINISTËR I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS  
Tiranë**

**Për dijeni:**

**Z. Lufter XHUVELI  
NËNKRYETAR I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT  
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE  
Tiranë**

Duke vlerësuar kërkesën Tuaj, për miratimin në parim të përdorimit të rezervës ujore të lumit Drin i Zi ndërmjet kuotave 441-285 m mbi nivelin e detit, dërguar me shkresën nr. 8012 prot, dt. 26.10.2007, si dhe prioritetin që ka qeveria për rritjen e kapaciteteve të prodhimit të energjisë elektrike, me datën 02.11.2007 organizuam një mbledhje jashtë radhe të KBU-së Drin Bunë.

**Pas shqyrtimit që u bë në këtë mbledhje, dhe diskutimit të anëtarëve, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Drin-Bunë mbështet kërkesën Tuaj për përdorimin e rezervës ujore të territorit të lumit Drin i Zi për prodhim energjie elektrike, me kusht që përdorimi i kësaj rezerve të mos krijojë efekte negative për komunitetin e kësaj zone.**

Për të dhënat teknike lidhur me sasinë e ujit që do te përdoret për prodhim energjie elektrike për një vepër të tille madhore, pranë Agjencisë së Ujit të Basenit mungon personeli i mjaftueshëm inxhiniero – teknik për të bërë vlerësime për volume të tilla, siç është rasti i ndërtimit të një H/C nje fuqi të instaluar prej afërsisht 350 MW.

Sipas akteve nënligjore, Agjencia e Bazenit Drin Bunë ka përgatitur deri tani informacione për H/C me kapacitet deri në 10 MW. Mendojmë se në të ardhmen duhet të plotësohet kuadri ligjor për përgatitjen e informacioneve për H/C mbi 10 MW.

Sipas Rregullores së Këshillit të Basenit Ujëmbledhës, në këtë mbledhje morën pjesë grupet e interesit, kryetarët e dhjetë njësisive të qeverisjes vendore të Qarkut Dibër (pa të drejtë vote) së bashku me Kryetarin e Këshillit të Qarkut Dibër, (anëtar i KBU-së Drin Bunë) të cilët u shprehën negativisht për ndërtimin e këtij H/C.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

PREFEKTI

**Maxhid CUNGU**